



Prishtinë, 02 shkurt 2026
Kodi i ZRRE-së: V_3015_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenit 25 dhe Nenit 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 3 paragrafi 1 nënparagrafi 1.19, Nenit 33, Nenit 39, Nenit 40 dhe Nenit 41 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Rregullës për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit, (Rregulla ZRRE/Nr.08/2017), e datës 13 prill 2017,
- Dispozitat e Nenit 19 të Licencës për Furnizim me Energji Elektrike të Korporatës Energjetike të Kosovës, SH.A., me numër Licence ZRRE/Li_60/17.
- Vendimin e Bordit të ZRRE-së nr. V_2932_2025 të datës 7 nëntor 2025, për Hapjen e Procedurës së Ri-Tenderimit për Zgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit,

në seancën e mbajtur më 2 shkurt 2026 nxori këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT
PËR PERIUDHË PREJ TRI (3) VITESH

- I. CAKTOHET KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A (KEK SH.A)** që të ushtrojë përgjegjësitë e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit (Furnizues i Garantuar), për periudhë prej **tri (3) vitesh**, duke filluar nga data **31 janar 2026 deri me 30 janar 2029**.
- II.** Furnizuesit të Mundësisë së Fundit (FMF) është i obliguar që të siguroj të gjitha shërbimet e furnizimit ashtu si janë përcaktuar në Ligjin për Energjinë Elektrike, Rregullën ZRRE/Nr.12/2017 për Kushtet e Përgjithshme për Furnizim me energji elektrike, Licencën përkatëse të lëshuar nga rregullatori dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
- III.** FMF është i obliguar të furnizoj konsumatorët që ngelin pa furnizues në rastet kur:
 - furnizuesi i tyre ka bankrotuar apo është në likuidim;
 - licenca e furnizuesit të mëparshëm është revokuar përkohësisht apo në mënyrë të përhershme, apo i ka skaduar; dhe
 - konsumatori ka dështuar në zgjedhjen e furnizuesit të ri pas ndërprerjes së kontratës me furnizuesin e mëparshëm.
- IV.** Furnizimi i Garantuar sipas pikës III të këtij Vendimi **nuk** mund të zgjasë më shumë se **gjashtëdhjetë (60) ditë**.

- V. Kostot e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit do të përcaktohen në përputhje me Nenin 6 të Rregullës për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit.

ARSYETIM

1. Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 29 korrik 2022 i kishte vendosur të drejtën për ushtrimin e funksionit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit KEK SHA-së, sipas Vendimit V_1544_2022, me afat prej 31 korrik 2022 deri me 30 korrik 2025.
2. Duke qenë se ky obligim do të skandonte me datë 30 korrik 2025, Bordi sipas dispozitave të Nenit 40 të Ligjit për Energji Elektrike me datë 28 mars 2025 ka nxjerr Vendimin Nr.V_2695_2025 për hapjen e procedurës së tenderimit për zgjedhjen e FMF-së.
3. Ftesës për shprehje të interesit për të aplikuar në Tenderin për Zgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, i publikuar me **19 prill 2025** në faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së, nuk i është përgjigjur asnjë aplikues.
4. Pasi që nuk janë plotësuar kriteret bazë të përcaktuara në Nenin 4 paragrafi 1 të Rregullës për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit (Nr.08/2017), i cili parasheh, citoj: *“Konkurrenca për caktimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit do të konsiderohet e vlefshme nëse jo më pak se dy (2) tenderues kanë përmbushur kriteret përkatëse të pranueshmërisë”*, ZRRE ka nxjerr NJOFTIM PËR ANULIM TENDERI për Zgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit.
5. Si rezultat i kësaj (dështim/anulim tenderi), Bordi ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet që të caktohet Furnizuesi i **përkohshëm**, ashtu siç përcaktohet edhe në Nenin 40 paragrafin 4 të Ligjit për Energjinë Elektrike, ku thuhet, citoj: *“Rregullatori do të caktojë një furnizues që përkohësisht të ushtrojë funksionin e furnizuesit të mundësisë së fundit, por jo më gjatë se gjashtë (6) muaj, periudhë kjo brenda të cilës do të zhvillohet tenderi i ri”*.
6. Kështu, me datë 12 qershor 2025 me vendimin V_2762_2025 Bordi ka caktuar Korporatën Energjetike të Kosovës që të ushtrojë përkohësisht përgjegjësitë e FMF-së për periudhë prej gjashtë (6) muajsh, nga data 31 korrik 2025 deri me 30 janar 2026.
7. Duke qenë se me datë 30 janar 2026 do të përfundonte afati që KEK të ushtrojë këtë përgjegjësi, Bordi me 7 nëntor 2025 ka nxjerr Vendim V_2932_2025 për HAPJE TË PROCEDURËS SË RI-TENDERIMIT PËR ZGJEDHJEN E FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT.
8. Me 18 nëntor 2025 është hapurt tender i ri, pra është publikuar Dosja e tenderit për FMF në web faqe të ZRRE-së dhe njëkohësisht dosja u është dërguar edhe me e-mail furnizuesve të licencuar nga ZRRE apo që kanë pasur njohje licence sipas parimit të reciprocitetit, nga ZRRE.
9. Afati për pranim të ofertave sipas dosjes së tenderit ka qenë deri me 17 dhjetor 2025, për çka ZRRE nuk ka pranuar asnjë ofertë nga të licencuarit.

10. Si rezultat i kësaj (dështim/anulim tenderi), është publikuar NJOFTIMI për Anulim Tenderi me datë 18 dhjetor 2025.
11. Bordi ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet që të caktohet Furnizuesi i Mundësisë së Fundi për periudhë tri (3) vjeçare, ashtu siç përcaktohet në Nenin 40 paragrafin 3 të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe sipas nenit 3 të Rregullës për FMF ku parashihet, citoj: *“Në rast se edhe tenderi i dytë dështon, Rregullatori cakton furnizuesin e mundësisë së fundit me një akt të veçantë, duke përcaktuar të gjitha kushtet dhe afatet për vendosjen e obligimit të shërbimit publik në pajtim me nenin 5 të këtij ligji. **Furnizuesi i mundësisë së fundit caktohet për një periudhë veprimi si furnizues i tillë prej tre (3) vitesh**”, si në dispozitiv të këtij vendimi.*
12. Bordi i ZRRE-së duke u mbështetur në dispozita ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vlerësuar që Korporata Energjetike e Kosovës, e licencuar për aktivitetin e furnizimit me energji elektrike, e cila ka deklaruar se do të pranojë këtë përgjegjësi (nëse i vendoset nga ZRRE); ka përvojën për të ushtruar këtë përgjegjësi; posedon sofuerin e nevojshëm për ushtrimin e këtij aktiviteti; posedon personel profesional; ka gjendjen e shëndoshë financiare, andaj ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- VI. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VII. Vendimi hyn në fuqi datën e aprovimit nga Bordi, dhe do publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Vendimi i dërgohet:

- Korporata Energjetike e Kosovës SH.A.
- KOSTT SH.A dhe
- Arkivit të ZRRE-së


Bordi i Rregullatorit:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Lutfije Dervishi, Anëtare


Gani Buçaj, Anëtar


Artan Isufi, Anëtare


Adnan Preniqi, Anëtar